



**U LUTA DHE HOXHA THA:
"AMIN!"...**



**NEVOJA PËR GJALLËRIMIN
E KULTURËS PERSONALE
DHE KOMBËTARE**



**HAFIZ ALI KORÇA...
VËSHTRIME RRETH FIGURËS SË TIJ**

UDHA ISLAME

Viti 19 - Nr. 6 (220), Qershor, 2021

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIA SHKODER1990

Koha për ta nxjerrë Islamin nga xhamia...



MYFTIU VIZITOI KËSHILLTARIN PËR ÇËSHTJET FETARE TË TURQISË

Paraditën e së martës, më 22 qershor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vizitoi në Tiranë Këshilltarin për Çështjet Fetare në Ambasadën e Republikës së Turqisë në vendin tonë, z. Bekir Yanılmaz.



Gjatë këtij takimi të përzemërt, Myftiu falënderoi kontributin e Këshilltarit Bekir Yanılmaz për ruajtjen e frymës së bashkëpunimit dhe vëllazërisë, për të cilën,... (f. 15)

IMAMËT E SHKODRËS, LIGJËRIME KUNDËR DEGRADIMIT MORAL E SHOQËROR

Në takimin e zhvilluar ditën e enjte, më 24 qershor 2021, me imamë të Myftinisë Shkodër, Myftiu Imam Muhamed B. Sytari, tërhoqi vëmendjen drejt domosdoshmërisë së shfrytëzimit të hytbes së xhumasë për të ngritur alarmin rreth fenomeneve degraduese të tabanit tonë kombëtar, përhapjes së dhunshme të injorancës, idhujtarisë moderne, imoralitetit e korrupsionit, mungesës së sigurisë dhe shthurjes, tentakulat e së cilës po përhapen frikshëm ditë pas dite... (f. 16)





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

KOHA PËR TA NXJERRË ISLAMIN NGA XHAMIA...

Në Kuranin Famëlartë ka një ajet në suren En-Nahl, që më ka tërhequr vëmendjen prej kohësh dhe, ditën e djeshme në një mbledhje me imamët e myftinisë sonë, pikërisht në këtë xhami, po thoja se ka ardhur koha që t'i drejtohem njerëzve dhe të ngremë alarmin për këto fenomene negative që po përhapen në masë në vendin tonë dhe po kalojnë pa asnjë lloj filtri, pa asnjë lloj vëmendje, pa asnjë lloj përkujdesje dhe po shfaqen e po prezantohen sikur të ishin lajme krejt të natyrshme?!

I hap sot kanalet televizive dhe është krejt e natyrshme të dëgjosh se dikush në një qytet prej qyteteve të Shqipërisë ka rrahur babain, apo ka nxjerrë në rrugë të madhe nënën, ose vëllau ka vrarë vëllanë, apo kushëririn ka masakruar kushëririn, apo motra, tezja, halla..! Këto janë realitete të frikshme!

Sot është bërë krejt e natyrshme që ti të hapësh mediat dhe të shohësh se kaq kg drogë, hashash e bimë narkotike janë ndalur këtu, janë kapur atje. Allah!

Sot është bërë krejt e natyrshme që ti të hapësh mediat dhe të shohësh se u vra ky, u vra ai, shpërtheu këtu, shpërtheu atje, u korruptua dikush! Këto janë të frikshme të dashurit e mi!

Nga po shkon kjo shoqëri?

Në të njëjtën kohë, mburremi duke thënë: "Mashallah xhamitë tona po mbushen me djem të rinj, po ndërtohen dhe inaugurohen përditë xhami të reja!"...!

Tashti, ejani pak dhe të vendosim në peshore këtë realitet. Si është e mundur që në një shoqëri që tërhiqet dita-ditës

drejt afetarizmit, drejt idhujtarisë, drejt imoralitetit, drejt shthurjes, drejt degradimit moral, drejt krejt të zezave, njëkohësisht të zhvillohet edhe thirrja islame, si kurrë më parë?!

A nuk është koha për të menduar se ne kemi nevojë ta nxjerrim Thirrjen Islame nga dyert e xhamive dhe mos të mburremi me ndërtimin e xhamive dhe me praninë e madhe të njerëzve në to, por ta shohim njësinë matëse të fetarizmit tonë të shëndoshë jashtë xhamisë?! Atje në rrugë, në tregti, atje ku komunikojmë me njeri-tjetrin, atje në rrugë ku është një varg i madh makinash dhe për shpirt do t'i kishim marrë krejt përpara nga nervozizmi dhe mungesa e durimit?!

Atje ku jemi duke blerë dhe e shohim tjetrin duke na vjedhur apo duke na mashtruar dhe nuk kemi kurajon për t'i thënë: "Kije frikë Zotin!"!

Është koha të gjejmë mënyra për ta nxjerrë Thirrjen Islame dhe moralin e fesë nga xhamia jashtë xhamisë, të dashurit e mi.

Në mënyrë që feja të jetohej në këtë shoqëri dhe mos të ngelet Islami dhe morali i tij thjesht një shfaqje e bukur, si bukuria e kësaj xhamie, që është shumë tërheqëse, dritë, bukur, ngjyra, bardhësi, rreze dielli, transparencë, mirëpo kur dalim në rrugë a jemi kështu?!

Dhe në jetën e përditshme a jemi ne muslimanë që e dëshmojmë Islamimin dhe dëshmohet e shikohet Islami në sjelljet dhe në komunikimin tonë me njeri-tjetrin?

**NË MËNYRË QË
FEJA TË JETOHET NË KËTË
SHOQËRI DHE MOS TË
NGELET ISLAMI DHE MORALI
I TIJ THJESHT NJË SHFAQJE E
BUKUR, SI BUKURIA E KËSAJ
XHAMIE, QË ËSHTË SHUMË
TËRHEQËSE, DRITË, BUKURI,
NGJYRA, BARDHËSI, RREZE
DIELLI, TRANSPARENCË,
MIRËPO KUR DALIM NË
RRUGË A JEMI KËSHTU?!**

Apo po kthehemi dita-ditës në njerëz të izoluar brenda komuniteteve tona, (po nënkuptoj me fjalën komunitete çdo xhami)? Saqë po fillon dhe po kthehet në trend të thuhet, edhe brenda një qyteti (dhe sa të vogla janë qytetet tona) se në xhaminë tonë falemi kështu, ju në xhaminë tuaj si falemi? Si e falni ju këtë namaz ose si e falni ju atë namaz, ose a e bëni ju këtë në xhaminë tuaj?! Allah! Kjo është anarshi! Ky është fodullëk! Kjo nuk ka lidhje me Islamin!

Kemi nevojë të dashurit e mi, të dalim nga xhamia, dhe ta dëshmojmë e të shihet kjo frymë e pastër e besimit në komunikimin tonë të përditshëm me njerëzit. Dhe jo ta konsiderojmë veten si njerëz të izoluar në realitetet tona!

Ne nuk jemi të izoluar, ne jemi taban i fortë në këtë vend! Ne jemi origjinë e vjetër dhe themel i fortë në këtë vend!

Dhe të mos pranojmë nga askush në botë, nga asnjë ligjëruar (edhe në petkat e mia), që të vijë e të na udhëzojë drejt një realiteti dhe një fryme që nuk është, që nuk duhet të jetë dhe nuk duhet ta pranojmë!

Ne nuk jemi të izoluar, ne jemi pjesë integrale e kësaj shoqërie dhe këtij vendi të lashtë, ne jemi kush jemi në këtë vend!

Ne kemi kontributet tona, kemi frymën tonë, djersa, munda, sakrifica e baballarëve, gjyshërve, shpirti i tyre, besimi i tyre, bamirësia e tyre është në origjinën dhe themelet e këtij vendi dhe kësaj toke. Mos t'ia kthejmë shpinën ne!

Thotë në suren En-Nahl: "All-llahu sjell si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) i përbuzën të mirat e All-llahut. Atëherë All-llahu, për shkak të sjelljes së tyre, ua veshi petkun (ua ngjeshi) e urisë dhe të frikës." - (Kurani, En-Nahl: 112)

Të ndalem tek ky ajet dhe të pyes: A nuk janë shfaqjet e dhunës, anarshisë, afetarizmit fanatik, imoralitetit, korrupsionit, e padrejtësisë që shtohen dita-ditës në këtë vend, shfaqjet e fudullëkut dhe injorancës deri në foltoret më të larta të kombit, a nuk janë shfaqje dhe dëshmi se diçka ka ndryshuar në marrëdhënien tonë me Zotin e gjithësisë dhe është koha të pendohejmë dhe të kthehemi nga Allahu (xh.sh), i Cili e ka begatuar këtë tokë dhe këtë vend tamam siç thotë në këtë ajet kuranor: "Riziko dhe begatitë i vinin nga çdo drejtim!"...!

Jemi të rrethuar me male, pyje, lumenj, me detra, me pasuri nëntokësore, mirëpo ku janë këto, ku është bereqeti i tyre në realitetet shqiptare?

Jemi një ndër vendet më të varfra në glob, ndërkohë që jemi një ndër vendet më të pasura e të rrethuara me mirësitë e Allahut (xh.sh).

A nuk është koha të pyesim dhe të themi, tamam sikur thotë Kurani Famëlartë: "Nga po shkoni?"

Nga po shkoni, realisht nga po shkoni? Nga po shkon shoqëria shqiptare, dhe nga po shkojmë ne muslimanët e këtij vendi?

Është momenti për t'u zgjuar të dashurit e mi dhe për t'u kthyer me pendim të singërt nga Zoti i gjithësisë, të Cilit i lutemi ta begatojë ditën tonë e natën tonë, dhe të na bëjë prej atyre që e dëgjojnë fjalën dhe veprojnë më të mirën e saj, që krenohen me Islamin e tyre, që nuk tundohen përpara thirrjeve të imoralitetit dhe shthurjes e të ndryshimit të natyrës, të cilën Allahu (xh.sh) na ka krijuar dhe na ka udhëzuar drejt saj, dhe të na bëjë prej atyre që me krye lart e jetojnë këtë jetë duke e dëshmuar mirësinë e Islamit me çdo njeri dhe me çdo krijesë prej krijesave të Allahut, për të cilat jemi urdhëruar që të jemi të dobishëm dhe dashamirës, dhe të duam për tjetrin atë që duam për veten tonë!

(Dersi i ditës së xhuma,
më 25 qershor 2021,
në xhaminë e lagjes Kiras, Shkodër)



Dr. Mustafa Mahmud
(1921 - 2009)

“

**NËSE PRISHEN RAPORTET
MES PAKICËS SË RRUQËS SË
DREJTË DHE SHUMICËS SË RRUQËS
SË QABUAR, ATËHERË ALLAHU NUK
KËRKON PREJ PAKICËS, VETËM
SE QËNDRESË DHE DHËNIEN E
MAKSIMUMIT TË MUNDËSIVE TË
TYRE, PASTAJ AI DO T'I TRIUMFOJË
ME MËNYRAT E TIJ!**

**Kjo është praktika e Tij,
e cila nuk ka ndryshuar
asnjëherë gjatë historisë ndaj
njerëzve në rruqën e drejtë,
ashtu siç ndodhi me ushtrinë
e elefantëve dhe ushtrinë e
ahzabëve.**

**Ky nuk është konkluzion leximi,
apo parashikim i së fshehtës,
por kjo është praktikë hyjnore!**

**Dhe kushti i vetëm për
zbatimin e kësaj praktike është
që myslimanët ta meritojnë
këtë gjë!**

”

**ËSHTË KOHA TË GJEJMË MËNYRA PËR TA
NXJERRË THIRRJEN ISLAME DHE MORALIN
E FESË NGA XHAMIA JASHTË XHAMISË..!**



Xhahid Bushati, shkrimtar

NË VEND TË PARATHËNIES

1. “Jules Renard i këshillon të gjithë ata që merren me shkrime: “Një shkrimtar duhet të shkruaj ashtu si merr frymë”. Pa dyshim që kjo është këshillë e vështirë për t’iu përmbajtur. Këtu, nuk ka të bëjë vetëm me tekstin ontologjik të shkrimit të përmendur por, gjithashtu në të njëjtën kohë nuk duhet harruar të theksohet edhe natyra dhe harmonia që bart shkrimi në vete.”^[1]

Citimi që bëra në hyrje të këtij studimi, mendoj që në disa pika i përshtatet madhështisë dhe poliedricitetit të figurës së Hafiz Ali Korçës.

Jam mrekulluar me vështirimet largpamëse teologjike.

Jam mrekulluar me filozofinë e tij, me vizionet.

Jam mrekulluar me shqiptarinë e tij.

Jam mrekulluar me dheun e MËMËS që e mbajti në shpirt.

Jam mrekulluar me kontributet e tij të vyera në shumë gjini dhe zhanre letrare.

Jam mrekulluar me Madhëstsinë e TIJ.

Jam mrekulluar..!

VËSHTRIMI I PARË

2. PËRBALLË MEJE... HAFIZ ALI KORÇA

Kam përballë meje kolanën prej 12 vëllimesh, me emrin e nderuar, largpamës, shndritës gjithë nur: **Hafiz Ali Korça**. E shqiptoj këtë emër me nderimin dhe respektin më të madh, dhe kuptoj se, Hafizi i ditur: U përball me kohën, triumfoi dhe bëri kohën e tij, u përball me epokën dhe bëri epokë triumfuese, u përballë me errësirën dhe bëri DRITËN e tij, që rrezaton ndër ne.

Kuvendimi me këtë opus vlerash që mbajnë shenjtëri brenda çdo gërme, çdo fjale, çdo fraze, ..., kuvendimi me Hafizin shpresëdhënës e plot urtësi, është i gjatë, dhe do të jetë i gjatë...

HAFIZ ALI KORÇA... - VËSHTRIME RRETH FIGURËS SË TIJ -

Shkrimet dhe krijimet, filozofia dhe përkthimet, interpretimet e shumë dukuri që sillnin kohërat në rrjedhën e tyre, në të shumtën e rasteve kanë sfiduar vitet dhe realitetet. Hafiz Aliu udhëtonte drejt dritës dhe përparimit. Kështu janë Kolosët..., “përkthehen” në modele të rralla, ku çdo Epoke i duhen domosdoshmërisht.

Ato vepra të çmueshme të asaj ‘Kolane’, edhe pse vështrojnë, ashtu, në mënyrë të madhërishe, flasin edhe në heshtje... Brenda faqeve të saj janë fiksuar realitete shpesh të turbullta e të hirta, shpesh dramatike edhe për të... Brenda faqeve të saj janë shpalosur dije shprese e jetëdhënëse për njeriun, për njeriun e vërtetë... Janë shpalosur dijet e një Dijetari të Madh që zemra e tij ishte toka mëmë, ishte Shqipëria, ishte Shqiptaria. Hafizi, në personalitetin e tij, e kam quajtur, aty ku drita kthehet në fisnikëri dhe fisnikëria kthehet në dritë.

Emocioni që më fal ‘Kolana’, është gjithashtu, i madh dhe i papërsëritshëm. Mendoj që jam përballë një Enciklopedie. Më duket sikur edhe ky krahasim është disi i mangët. Vetiu më vjen në mendje ta krahasoj me një Universitet. Po e lëmë kështu. I tillë është! Pra, ngado që të marrësh udhën, pra të trokasësh në çdo portë të këtij libri, e kupton menjëherë se shkon drejt dijes së vërtetë, drejt viteve, drejt vlerave të të pazëvendësueshme, drejt njohjes e kërkimit të panjohjes, drejt një magjie diturake e urtaje, të cilat me shumë përkushtim e sakrificë, sakrificë deri në dhembje na e fali mirësia e talenti i Dijetarit të Madh. I urtë, i pafjalë, i thjeshtë, me plagë e dhimbje në shpirt e në zemër, i vetmuar por i papërkuluar, modest por gjer në madhësi, deri në pavdekësi. Me një spikatje rrezatuese.

Ky autor, në procesin krijues me shkrimet e tyre (të gjinive dhe zhanreve të ndryshme) la emrin, shenjat dhe gjurmët e tij për t’i njohur brezat e për t’i përvetësuar, për të kuptuar se kush ishte e djeshmja, kush është e sotmja dhe kush është e nesërmja. Ndaj, Hafizi u kthye në Kujtesë. E, kjo nuk është pak. Ingjan një përmendoreje, ku Hafizi dhe Historia flasin me zërin e së vërtetës. Flet autentikja, pra kombëtarja, flasin mesazhet, flet mbarësia si në dritën e diellit: larg mashtimit, heshtjes, fshehjes, injorancës, deformimit dhe

përgënjeshtimit.

Shfletoj me kujdes çdo faqe... Në atë fëshfëritje flete më flet një kronikë, një ndodhi, një ngjarje, një poezi, një përkthim, një shkrim publicistik, një abetare, një hadith, pjesë Kur’anore, një personazh, një akt bese, një fjalë e fundit, një amanet, një histori... Më flasin vizionet, se Hafiz Ali Korça ishte vizionar i madh.

Komunikoj me çdo fjalë, me hapësirën e saj. Komunikoj me autorin (edhe pse pas kaq vitesh), me kumtin e tij që të fal dhe të përcjell, me nëntekstin, me sekretet e krijimit, me fjalët kyçe që mbartin, me mesazhet që përcjellin... Dhe në shpirtin tim hyjnë si pakuptuar motive të pafund... U qasem me vëmendje.

Në këtë shumësi vlerash njohëse, kulturore, të virtytshme e edukative; po bëj përpjekje për të zbuluar e studiuar sadopak vertikalitetin e kësaj veprë madhore në historinë e islamologjisë, filozofisë dhe kulturës shqiptare, siç është vepra madhore e Hafiz Ali Korçës.

Hafiz Ali Korça, Madhështia vetë!

VËSHTRIMI I DYTË

3. Drita dhe personaliteti i Hafiz Ali Korçës

Njëri nga bashkëpunëtorët e ngushtë të revistës “Zani i Naltë”, që në fillesat e saj dhe në disa numra më pas, qe dhe Hafiz Ali Korça. Nderimi për veprën e tij është pak të thuash nderim. Mbase duhet kërkuar ndonjë fjalë tjetër magjike në fjalorë, epistolarë a enciklopedi. Burrë i ditur, burrë i mençur. Me një diapazon të gjerë kulture dhe rrezatim diturie. Nga ata burra, ndonëse të pakët të kësaj natyre tipologjike nderojnë Kombin. Poliedriciteti i figurës së tij, më sjell ndërmend Nolin e Madh.

Hafiz Ali Korça - Atdhetar dhe luftëtar në Lëvizjen kombëtare, kontribues i pashoq në fushën e arsimit, të gjuhës, të letërsisë për fëmijë. Gjithashtu, kontribues i pashoq në lëmin e historisë, islamistikës, kulturës (poet e përkthyes), publicistikës, filozofisë, etj. Me një rrugë të gjatë, të mundimshme me plot dhembje e sakrificë. Si askush. Në këtë rrugë të gjatë, teksa Hafizi i nderuar shpërndante rrezatimin e diturisë së tij, erudicionin dhe poliglotesinë, kurrë nuk e kishte menduar se do të kishte ditë dhe

vite, që Ai do të njihej edhe me fjalët e tmerrshme: harresë, shpërfillje, periferi, joprotagonist, izolim, burg, drobitje, mjerim, tragjizim, dëshpërim, etj. Po citoj këto dy fragmente për të përligjur argumentet e mësipërme. Fragmenti i parë: “Një plak krenar, me shtat të bëshëm, me mjekër të zezë e çallmë mbi kokë, me xhybe të zezë, përplot fuqi e i pathyeshëm, dukej Ai pas Luftës së Dytë Botërore.” Fragmenti i dytë: Kur u internua në Kavajë. “... dukej i molisur, i lodhur shpirtërisht e fizikisht, i izoluar në këtë qytet të vogël. ...

Vitet e fundit ndjehej i braktisur.” Hafiz Aliu ruajti në subtancën e emrit dhe mbiemrit të tij, si gur të çmuar fjalën e bukur shqipe: Korça. E përjetësoi. Më sjell ndërmend Lasgushin, poetin modern të letrave shqipe. Poradecin e tij të dashur e të shtrenjtë edhe ai e gdhendi si mbiemër. Hafiz Aliu, i nderuar!.. Foli dhe u shpreh shqipërisht në mënyrë të madhërishe. Fund e krye. Me shqipen e zemrës, me shqipen e shpirtit, me shqipen-amanet; ndonëse në jetën e tij, në atë të lindjes kishte një prill, muaj që të kujtojnë lulet; ashtu si në pragvdekjen e tij kishte një dhjetor që të kujtojnë: acarin, dëborën e dhimbshme, të ftohtin, erën e tërbueme. Hafiz Aliu, i nderuar!..

Në pragvdekjen e tij më kujton Migjenin. Se Hafizi qe një figurë tragjike, po ashtu dhe Migjeni – figurë tragjike. Se Hafizi pati një vatër drite që ndikoi në formimin e tij dhe quhej: Stamboll. Po ashtu edhe Migjeni – vatra e tij e formimit quhej Manastir. Trashëgimia që na la Hafizin, është botuar si kolanë prej 12 veprash nga Shtëpia Botuese Logos A, në vitin 2006. Nderim për këtë Shtëpi Botuese! Akt fisnik i saj! Nuk ka panteon më të bukur se sa opusit jetëdhënës e diturues të Hafiz Ali Korçës, i ka bërë kjo Shtëpi Botuese!

VËSHTRIMI I TRETË

4. ‘Shenjat’ e Hafizit...

Hafiz Ali Korça ishte një figurë poliedrike. Çdo faqe e këtij poliedri ka shkëlqimin e mendimtarit dhe të bibliotekës së tij. Çdo faqe e këtij poliedri ka bekimin e tokës që e lindi, ku çdo copëz të saj e “vaditi” dhe e ushqe me zemrën dhe shpirtin e tij që ia përvëlue, që ia dogjën sa më s’ka. Atdhedashuria e Hafizit është një ‘XHYBE’ që s’mund ta vesh kushdo...

Kontributet e Hafizit në gjinitë e zhanret e ndryshme që lëvroi, ishin gjurmëlënëse. Këtu, duke përfshirë edhe konceptet e tij filozofike, sociale, juridike (fetva-të) etj., e në mënyrë

**Hafiz Ali Korça,
dijetari i madh, i urtë,
i pafjalë, i thjeshtë, me
plagë e dhimbje në shpirt
e në zemër, i vetmuar por
i papërkuluar, modest por
gjer në madhësi, deri në
pavdekësi. Me një spikatje
rrezatuese.**

të veçantë mbi religjonin (religion, religiosity), e në mënyrë më të veçantë mbi Myslimanizmin dhe myslimanët, që gjithë jetën e tij këto dy nocione të dritshme i zbërtheu, i interpretoi duke u dhënë dritë prej HAFIZI. Mendja e tij prej Dijetari-hulumtues qe e ndritshme, gjithëpërfshirëse sa çdo tekst i Hafizit i ngjan diellit të mëngjesit që ta ka ënda, që sjell ngrohtësinë dhe gjelbërimin e një ditë të vlefshme, të dobishme e të mbarë; aromën e saj sa hyjnore aq dhe njerëzore.

Por vëmendja ime kësaj radhe ka “stacionuar” në vëllimin e parë të kolanës së revistës “Zani i Naltë”, e, që përfshin vitet 1923, 1924 e 1925; ku ndihmesa, kontributet dhe ‘shenjat’ magjike, poetike, atdhetare e filozofike të Korçës janë të dukshme, “të prekshme”, interesante dhe të papërsëritshme. Veçori kulture e tharm realiteti. Të gjitha këto prurje (gjurmëmbara, që vit pas viti, do të shtohen e rriten), të cilat zanafillën e shfaqjes së parë, të jetës prej dijetari të papërsëritshëm të Hafizit, e kanë në misionin e kësaj Reviste të çmueshme dhe... ku herët (që në tekstet e para) shfaqet dhe përcaktohet si individualitet (me cilësi intelektuale, fetare, krijuese dhe kulturore). Po kështu i tillë është, po kështu i tillë mbeti edhe në peizazhin letrar të atyre viteve që përkujnë (duke përfshirë materialet dhe tekstet e tij në Revistën “Zani i Naltë”^[1].) Paçka se studiuesit dhe kritikët nuk e njohën dhe aq mirë, sa që mbetën anemikë, shpesh dhe liliputë, para madhësishtisë dhe dijeve të Hafiz Ali Korçës.

VËSHTRIMI I KATËRT

5. Hafiz Ali Korça dhe poezia “Vajtimet e Atdheut”

Hafiz Aliu (nënkupto Hafiz Ali Korça) në revistën “Zani i Naltë”, nr. 11, gusht 1924 botoi poezinë “Vajtimet e Atdheut”. Kjo poezi me natyrë, frymëmarrje dhe theks elegjiak është

përfshirë në vëllimin e parë të kolanës “Zani i Naltë”, e cila përfshin vitet 1923 – 1924 – 1925. Poezia autoriale është paraqitur dhe shënjohej në faqen 349 të kësaj kolane. Më pas kjo poezi vajtimtare është përmbledhur në kolanën e veprave të Korçës e, pikërisht në Veprën 2, botuar nga Logos A, Shkup, 2006. Kjo poezi me titullin trishtues, plot dhembje, lot e vajtime “Vajtimet e Atdheut”, që ia kushton Kosovës është dhe jeton brenda hapësirës së vëllimit “Shtat ëndrat e Shqipërisë”.^[2]

Po të bëjmë krahasimet e botimeve, mendojmë që te kolana “Zani i naltë” l, nga pikëpamja e kompozicionit dhe strukturës së poezisë, theksohen më qartas veçoritë e konceptimit të saj. Po në këtë vëllim është treguar edhe një kujdes në ndërhyrjen ortografike, me qëllimin për ta bërë sa më të lexueshme poezinë e Korçës. Ndërsa në kolanën e veprave të Hafiz Aliut është ruajtur autentikja e botimit origjinal të autorit.


Përse u ndala te kjo poezi elegjiake? Gjatë leximit tekstor, nocioni i kohës ishte i pranishëm. Vetë, koha “shëtiste” në tre plane: në të djeshmen, në të sotmen dhe në të ardhmen. Një marrëdhënie e shumëfishtë, sepse vetë kjo kohësi përkonte në ekzistencën e saj. Rrekej drejt lirisë. Rrekej të jetonte. Kjo njëra anë. Ana tjetër: për të pohuar dy dukuri të Hafizit të nderuar, të shtrira në kohë dhe në hapësirë. E para, e gjithë krijimtaria letrare përshkohet e shënjohej nga motivi patriotik e atdhedashës i tij. E dyta, shpërfaqet shpirti shqiptar, thellësisht shqiptar i shqiptarizms së Ali Korçës, siç thotë vetë “i një atdhetari idealist”.

Poezia në fjalë, si në substancën e saj, si në titullin që mbart; flet e komunikon përmes një simbolike tronditëse që gjen plazmim në çdo figurë poetike e në çdo varg të saj. Kjo është dhe arsyeja që nga pikëpamja e teknikës së vargëzimit është shkruar në monokolonë. Gjegjësisht e përligjur.

Në poezinë e Hafizit, Kosova, edhe pse përmes lotëve, jeton e bukur dhe e dritëshme. Ajo është një mrekulli që ‘folenë’ e ka në shpirtin e madhërishtë të Hafizit. Kuvendimi i tyre në këtë poezi shfaq sublimen dhe dashurinë e Dheut.

[1] SU HUSEYIN: Shkrimi dhe Fati, Fleta, Prizren, 2019, shkrimi: “Rreth shkrimit dhe fatit”, f. 5.

[2] Korça, Hafiz Ali: Shtat ëndrat e Shqipërisë, Vepra 2, Vajtimet e atdheut, f. 121 – 125; Logos A, Shkup 2006.



Sheikh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

Ndjej në këto ditë se nevoja për të ngjallur kulturën personale është shumë e madhe, për të pastruar atmosferën e saj dhe për të zgjeruar shtrirjen e mëtejshme, sepse kolonizatori kulturor ateist ka arritur sukses në shkatërrimin e personalitetit tonë kuptimor, në prishjen e mendjeve të mijëra njerëzve nga besimi ynë, ashtu siç pati sukses në shthurjen e gjuhës sonë, në palosjen e strukturës dhe në nëpërkëmbjen e të drejtave tona, duke na futur në shoqërinë ndërkombëtare, pa asnjë tipar dallues të vërtetë dhe pa asnjë identitet të veçantë. Kjo është ajo humbja e plotë!!

Ndoshta dikush prej nesh, mundet të marrë grada shkencore në mjekësi, jurisprudencë. Madje, mund të emërohet në postet më të larta në Evropë apo Amerikë, por lidhja e tij me fenë e vet është zero. Marrëdhëniet e tij me kombin janë gjithashtu zero. Në të njëjtën kohë, kolegu i tij hebre është si uragan në shërbim të sionizmit dhe kolegu i tij i krishterë është më i shpejtë se vetëtimat në shërbim të kolonizatorit! A mundet që ky mysliman me ndjenja të ftohta, t'i bëjë ndonjë dobi popullit të vet? Pa dyshim ai i ngjan një mercenari që me armën e tij i shërben çdo parimi për një copë bukë dhe për thërrimet e kësaj bote!

Përhapja e arsimit në vendet tona, duke e zhveshur atë nga kultura jonë kombëtare dhe përkatësia jonë e kufizuar, është një gjë e dëmshme dhe s'të gëzon aspak, të shqetëson dhe s'të lë të qetë.

Kur të kthehemi tek ligjet tona shpirtërore e intelektuale, pa dyshim që duhet të largohemi nga shumë gjëra të ndaluara.

• Shtyllat e fesë tek ne janë shumë më pak në sasi dhe formë se, sa librat

NEVOJA PËR GJALLËRIMIN E KULTURËS PERSONALE DHE KOMBËTARE

që i shtjellojnë ato. Debate boshe të mbledhur në to, kanë shumëfishuar çështjet e tyre pa as më të voglin shkak. Kryesorja është që të përkrahen me zemër, të shndërrohen në forcë shtytëse dhe në dritë që ndriçon rrugën.

• Adhurimet dhe shkencat e tyre nuk janë dete të kobshme pa brigje. Ato në fenë tonë janë të lehta në kuptim dhe në realizim.

Ka disa njerëz që kanë qejf të shpjegojnë pastrimin e namazit, në një muaj kohë! Të parët, të mëdhenj e mësonin fenë e tyre me orë të pakta, çanin fushat e jetës me islamin e tyre, me shpirtin e tij, duke u nisur prej qëllimeve të tija me seriozitet e me sinqeritet.

Po, ndoshta mund të ketë njerëz të specializuar në studime të caktuara dhe për specializimin ekzistojnë njerëzit dhe kushtet që duhen, ashtu si dhe në çdo fushë tjetër shkencore.

• Ngritja e personave mbi moralin e lartë dhe ndërtimi i shoqërive mbi traditat e ndershme janë shtyllë e shtyllave në fenë e Zotit të Madhëruar. Edukimi është si bujqësia dhe industria, është punë që kërkon sakrificë të madhe, ku marrin pjesë elementë të shumtë e jo fjalë apo predikime prekëse. Si mundet të pastrojmë shpirtat nga koprracia, smira, mendjemadhësia dhe dyfytirësia? Si mundet të ndërtojmë njerëz që e duan të përsosurën, përvëlohen për të bukurën dhe të mirën, refuzojnë anarshinë e parregullsinë?

Në atë popull ku feja e tij e urren nxitimin, përse përhapet pa korrektësi e neglizhenca nëpër zërat e tij?! Në atë popull ku jurisprudenca (fikhu), ngrihet mbi pastërtinë, përse janë të përhapur mbeturinat e papastërtisë e të hipokrizisë?! Tradita e hipokrizisë në mënyrat e ngrënies, pijes, veshjes, martesës dhe në çdo gjendje tjetër, po vret burrat e gratë! Ku është lehtësia, sinqeriteti dhe modestia, ndërsa në themel të fesë sonë është originaliteti?

KULTURA KOMBËTARE

Kultura kombëtare është pasuri me shumë vlerë përcaktuese për një popull.

Nga këtu, kolonizatori u drejtua për të goditur këtë kulturë dhe, të dobësonte institutet e saj, ta zhdukte, ose ta paralizonte lëvizjen e saj, duke

e lënë atë shterpë, apo emër pa gjë. Kjo është ajo që ndodhi në universitetin El-Karavijn, Ez-Zejtune, Al-Ez'her dhe universitetet islamike në Libi, Sudan e në vende të tjera. Si rrjedhojë e kësaj pasuan dy gjëra të rrezikshme: Shuarja e mendimit islam dhe dobësimi i studimeve fetare, pastaj shuarja e gjuhës arabe dhe literaturës së saj, tkurrjen e saj përballë përparimit qytetërues, pakësim i folësve të saj dhe shtim të atyre që e flasin me gabime pa pikën e turpit.

“**PËRHAPJA E ARSIMIT NË VENDET TONA, DUKE E ZHVESHUR ATË NGA KULTURA JONË KOMBËTARE DHE PÛRKATËSIA JONË E KUFIZUAR, ËSHTË NJË GJË E DËMSHME DHE S'TË GËZON ASPAK, TË SHQETËSON DHE S'TË LË TË QETË.**

KUR TË KTHEHEMI TEK LIGJET TONA SHPIRTËRORE E INTELEKTUALE, PA DYSHIM QË DUHET TË LARGOHEMI NGA SHUMË GJËRA TË NDAJUARA.

Mbasi politikanët arabë dhe udhëheqësit e tyre janë prej të diplomuarve në studimet jofetare, më shumë se 99% e tyre ndodhen larg në mendime nga kultura jonë kombëtare, si pasojë e kësaj, progresi islam herë përparon e herë mbetet prapa. Edhe në qoftë se përparon ndonjë hap, me vështirësi të vazhdueshme e bën.

Ndërsa të flasësh për vetë fenë, është bisedë e lodhshme dhe kujtesë për diçka që ka vdekur, ose që duhet të vdesë. Por kjo ndjenjë mbështillet me urrejtje, me shprehje të bukura, ose respekt artificial, për t'u mbrojtur nga zemërimi i popullit.

Në një shoqëri të nënçmuar, e cila i ka humbur vlerat e saj, ose ka degraduar, feja konsiderohet prapambetje, namazi zënie e kohës dhe agjërimi pengesë e prodhimit!

Shkëputur nga libri: "Probleme në rrugën e jetës islame"
Përktheu nga arabishtja dhe përshatati në shqip:

Lavdrim Hamja

U LUTA DHE HOXHA THA: “AMIN!”...

25 mars 2021. Në Tetovë, akoma kishte dëborë. Dimri vazhdonte të mbulonte tokën me pelerinën e bardhë ndonëse rrezet e diellit shkëlqenin, duke ia zbkuruar panoramën stinës së ftohtë.

Atë ditë, përtej takimeve të përzemërta me vëllezër e miq të mirë, prej atyre me të cilët më lidhin studimet, drejtimi, Hoxha, shkolla haneftë, tradita shekullore e Thirrjes Islame në trojet tona, respekti e mirënjohja e fshehur në zemër; mendja më rrinte tek një dëshirë e kahershme për të takuar nga afër njërin prej burrave të urtë e shërbyesve të zellshëm e të heshtur të kësaj feje të madhnueshme islame...

I dua të mirët, pas dritës së tyre shkoj! Kjo thirrje më ka shoqëruar përherë në jetë. Kudo ku kam shkuar e çdo vend që kam vizituar, kam pyetur për burrat e heshtur, burrat e bardhë, eulijatë e dashur, që ishin dhe mbetën bereqeti i çdo kohe e çdo vendi..!

Para tyre, ndjehesh si në prehrin e prindit, si në qoshkun e mexhlikeve të larta të dijës e urtisë, si në ndenjat plot dashni e rahmet të atyre, që me gjendjen e tyre shpirtërore, sinqeritetin e përkushtimin e tyre të rrethojnë e, pa prituri e menduar të dhurojnë dritë nga nuri, me të cilin janë begatuar, si një kader i shenjtë, me të cilin Zoti i gjithësisë don të të dëshmojë dashninë e Tij për ty!

Si jo, kur Resulullahu (a.s) lutej: “Allahume unë të lutem të më dhurosh dashninë Tënde, dashninë e atyre që të duan dhe dashninë e atyre, që më vlen dashnia e tyre tek ti!”.

Kështu e ndjeva veten të bekuar e të rrethuar me mirësi e paqe shpirtërore, atë pasditë të begatë të asaj vizite të paharruar në Tetovë, para duarve të Mualimit e Muhafizit të madh të trojeve tona, të dashurit e të shtrenjtë Mulla Mahmud ef. Asllani, që sapo mësova se, nga sot, do të jetë pjesë e ndritur e historisë së lavdishme të Thirrjes Islame në trojet tona!

Nga sot, do të jetë një emër i nderuar në memorien e secilit prej nesh, do ta shoqërojmë emrin e tij me nderim e lutje: “Rahmet pastë shpirti i tij!”, do ta kujtojmë e do ta mbajnë mend gjatë talebetë e tij, imamët e studiuesit



A TË PASDITE, MULLA MAHMUD EFENDIU KISHTE NJË BRENGË, PËR TË CILËN NUK HEZITOI TË MË PYESTE: “KUR DO TË MBAROJË KJO TOLLOVI? A DIN QJA, SE KUR DO HAPEN KURSET E KURANIT?”... AJO ISHTE BRENGA E TIJ, DËSHIRA PËR TË PARË FËMIJËT E TALEBETË PARA DUARVE, DUKE LEXUAR KURAN, DUKE MËSUAR E PËRSOSUR MËSIMIN PËRMENDËSH TË FJALËS SË ALLAHUT!

islamë të Tetovës, por jo vetëm!

Ajo ditë marsi në Tetovë, më zbuloi mbi të gjitha fuqinë që ka besimi dhe besa e lidhur me Zotin, për t'i shërbyer në të mirë e në të keq, për të mos u kthyer kurrë pas, për të vazhduar deri në frymën e fundit.

Atë pasditë, Mulla Mahmud efendi kishte një brengë, për të cilën nuk hezitoi të më pyeste: “Kur do të mbarojë kjo tollovi? A din gja, se kur do hapen kurset e Kuranit?”... Ajo ishte brenga e tij, dëshira për të parë fëmijët e talebetë para duarve, duke lexuar Kuran, duke mësuar e përsosur mësimin përmendësh të Fjalës së Allahut!

Bri meje, i biri, Hoxha Abdurrahman, më thoshte me fytyrë të qeshur, se që kur ka rënë pandemia dhe janë ndaluar kurset fetare, edhe kur shtrihet për të fjetur, Baba, edhe në gjumë dëgjohet duke mësuar nxënësit e tij..!

Subhanallah, ai kishte arritur në

gradën e fenasë, shkrirjes, me Kurandin dhe mësimin e tij, si për të na dëshmuar se: “Njerëzit e Kuranit, janë njerëzit më të afërt të Allahut dhe më të dalluarit e Tij”, siç urdhëron Resulullahu (a.s)...

Atë pasditë ne folëm e folëm, si të njiheshim që në ezel e, si të ishim pjesë e një bese e një drejtimi, siç në të vërtetë ishim e jemi!

Atë pasditë, i kërkova Mulla Mahmud efendisë të lutej për mua. Ai buzëqeshi e insistoi që mysafiri ta bënte duanë, ndonëse mysafiri, para duarve të tij po përjetonte një kënaqësi të munguar prej kohësh dhe mezi priste që Hoxha plak të lutej për të...


U luta dhe Hoxha tha: “Amin!”...

Allahu të mëshiroftë e në xhenetet e larta të pranofte, Mulla Mahmud Efendi Asllani!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 21 qershor 2021



Prim. Dr. Med. Sc. **Ali F. Iljazi**

Për artin e bashkimit të zemrave na ka treguar Pejgamberi, (a.s) gjatë misionit të tij profetik, si dhe ata që janë edukuar nën mbikëqyrjen e zgjuar të tij si dhe ata që pas tyre kanë pasuar rrugën e tyre. Do t'i tregojmë disa principe të këtij arti.

1. MBIZOTËRIMI I HIDHËRIMIT

Allahu i Madhërishëm në Kuranin fshik thotë: "...ata që frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit."

Ekzistojnë tre shkallë për mbizotërimin e hidhërimit: e para, e mesme dhe shkalla e bamirësve.

Shkalla e parë, është e atij të cilit i bëhet e keqja dhe ai përmbahet dhe nuk i ekspozohet kurrfarë mos kënaqësie- "ata që e frenojnë mllëfin"

Shkalla e dytë, është e atyre që bëjnë mirë "njerëzve u falin". i këtilli shkon tek ai i cili i ka bërë keq dhe i thotë: "Allahu të faltë".

Shkalla e tretë, është e atij i cili rritë të mirën: "Allahu i do bamirësit". I këtilli shkon në vizitë tek ai i cili i ka bërë keq, i dërgon dhuratë dhe përshëndetet me te.

Tregohet që shërbëtori i Harun er-Reshidit duke sjellë ibrikun me ujë të nxehtë për të shërbyer halifin, rrëshqiti dhe uji i vluar e përcëlloi halifin. Haruni u zemërua, ndërsa shërbëtori ishte mendjemprehtë dhe i tha: "Ata që frenojnë mllëfin." Halifi i tha: "E mbizotërova mllëfin." Shërbëtori tha: "Dhe falin njerëzit." Në këtë halifi tha: "Të fala." Pastaj shërbëtori vazhdoi e tha: "Allahu i do bamirësit." Ndërsa halifi tha: "Shko, je i lirë për hir të Allahut".

2. MËNJANIMI I KEQBËRJES DHE URREJTJËS

Në Luftën e devesë u ballafaquan Aisha r.a. Talha, Zubejri dhe sahabët e tjerë r.a. në një tabor, me Aliun (r.a)

ARTI I BASHKIMIT TË ZEMRAVE

dhe disa sahab, pjesëmarrës të Bedrit në taborin tjetër. Kur Talha (r.a) u vra gjatë luftës, edhe pse ishte në taborin kundër Aliut (r.a), imam Aliu zbriti nga kali i tij, e futi shpatën në këllëf, u gjunjësua para Talhës, e shikoi dhe i tha: "Më vjen rëndë, Ebu Muhammed, të shohë në këtë gjendje, por i lutem Allahut të na bëjë prej atyre për të cilët i Lartësuar thotë: "Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtje, e ata në mbështetësi qëndrojnë ballë për ballë njëri tjetrit duke qenë të vëllazëruar."

Shikoni këtë shembull të bukur, këtë pastërti, ata ishin në betejë por pa marrë parasysh këtë Aliu (r.a) e shtrëngon në përqaftim Talhën (r.a) dhe e kujton që me të do të hyjnë në Xhenet. Ky shembull tregon që sahabët prapëseprapë kanë qenë njerëz, jo melek, por ishin shembulli më i mirë për njerëzimin.

3. SAKRIFICA E FAMËS DHE PASURISË NË RRUGËN E ALLAHUT

Ebu Damadam falej natën e pastaj i lutej Allahut: "O Zoti im, unë nuk kam pasuri që ta ndajë në rrugën Tënde, as trup për të luftuar për Ty, por do ta ndaj krenarin time të cilën e kanë përçmuar myslimanët tjerë. O Zoti im, ai i cili më ka sharë ose më ka fyer, ose më ka bërë padrejtësi, ose më ka përgjuar, bëja (kefaret) shpagim!"

Transmetohet që një ditë Pejgamberi, (a.s) i nxiste sahabët në dhënien e lëmoshës dhe u ngritë Utbe bin Zejd duke thënë: "O i Dërguar i Allahut, po na nxitë në dhënien e lëmoshës ndërsa unë nuk kam asgjë përveç krenarisë sime, dhe ia ndaj atij që më ka bërë padrejtësi." Ditën tjetër erdhi Pejgamberi, (a.s) dhe tha: "Ku është Utbe bin Zejd, dhënësi i krenarisë së tij, Allahu e pranoi nga ai."

4. PËRBALLIMI I GABIMEVE TË TJERËVE

Shënohet se tek Hasani Basriu erdhi një njeri dhe i tha: "O Ebu Seid, filan personi të ka përgjuar." Hasani ia dha një enë me hurma duke i thënë: "Shko e thuaj, mi ke dhuruar veprat e tua të mira, e unë po të dhuroj për këtë enë me hurma!"

Transmetohet që Musai a.s. ka thënë: "O Zoti im më prano diçka!" Allahu i tha: "E çfarë është kjo, o Musa?", ndërsa Ai më së miri e di çfarë është ajo. Musai i tha: "Të lutem o Zot, të më ruash nga gjuhët e njerëzve." Në këtë Allahu i

tha: "O Musa, betohem në krenarinë dhe lartmadhërinë Time, Unë vetit nuk ia kam bërë këtë cilësi, Unë i krijoj, i furnizoj e ata më shajnë!"

Pra, njeriu kjo qenie e dobët, e mjerë, e përbuzur e shanë Allahun?! Qoftë i lavdëruar i Lartmadhërishmi, Një i cili nuk ka lind askënd as nuk ka lind nga askush, dhe asgjë nuk është i barabartë me Atë.

Buhariu transmeton nga Ebu Hurejre (r.a) që Pejgamberi, (a.s) ka thënë: "Ka thënë Allahu i Madhërishëm: 'Më shanë i biri i Adem, e kjo nuk i përshtatet me më sharë, më futë në gënjeshtëri, e kjo nuk i përshtatet! Sa i përket sharjes, janë fjalët e tija që unë kam djalë, e sa i përket futjes në gënjeshtëri, janë fjalët e tija- nuk do të më Krijoj përsëri siç më ka krijuar herën e parë.'"

5. VETËLLOGARITJA

Erdhi një njeri në Qabe, dhe filloi të kritikonte Ibn Abbasin (r.a) para njerëzve, ndërsa ai ulte kokën. Ai vazhdoi edhe më tej të kritikonte njeriun, i cili ishte dijetar i shquar i kohës, ndërsa Ibn Abbasi duke ngritur kokën i tha: "A po më shanë, përderisa unë i kam tre cilësi të bukura?" Njeriu e pyeti: "Cilat cilësi të bukura i ke?" Ibn Abbasi u përgjigj: "Betohem në Allahun se nuk bie (zbret) shi në Tokë e unë të mos gëzohem dhe të falënderoj Allahun në këtë, edhe pse vet nuk kam as ara, as livadhe, as deve e as dele." Njeriu përsëri e pyeti: "Po cilësia e dytë e bukur që ke?" Ibn Abbasi i tha: "Nuk dëgjoj për asnjë gjykatës të drejtë, e që të mos lutem për te tek Allahu në mos prezencën e tij, edhe pse nuk kam tek ai akt padie." Njeriu vazhdon të pyet: "Po e treta cilësi e bukur?" Ibn Abbasi i tha: "Nuk e kam kuptuar asnjë verset nga Libri i Allahut, e që nuk kam dëshiruar që myslimanët ta kuptojnë si unë".

Këto janë disa nga cilësitë që kanë poseduar sahabët që u edukuan në kohën e Pejgamberit (a.s) dhe atyre që pasuan ata. Ata ishin mjeshtër të artit të bashkimit të zemrave të njerëzve. Bekimi dhe mëshira e Allahut qoftë mbi Pejgamberin (a.s), shokët e tij dhe gjithë ata që i pasojnë këta deri në Ditën e Gjykimit, e neve na bëftë prej atyre që bashkojnë zemrat e besimtarëve.

(www.islamgjakova.net)



Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Njeriu në jetën e kësaj bote kalon nëpër situata të ndryshme. Njeriut ose i dhurohen të mira, për të cilat duhet të shprehë mirënjohje e falënderim ose goditet nga sprova e fatkeqësi, të cilat duhet t'i durojë. Sa më të fortë që besimtari ta ketë besimin, aq më falënderues dhe durimtar është.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Është për t'u habitur me besimtarin, sepse çdo gjë që i ndodh është në të mirën e tij: Nëse i dhurohen të mira, ai falënderon Zotin dhe kjo është në të mirën e tij; kur i ndodhin fatkeqësi, bën durim, gjë që përsëri është në të mirën e tij. Kjo vlen vetëm për besimtarin."¹ Pra, besimtari është në mirësi të vazhdueshme, çfarëdo që të përjetojë në jetë: begati apo fatkeqësi.

Nuk është për t'u çuditur që ajeti i parë në Kur'an pas "Bismil-lahit" është ajeti që i bën besimtarët të ndiejnë begatinë e Allahut dhe i orienton ata që ta falënderojnë Atë. Ai është ajeti i kaptinës "El-Fatiha": "Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve!"² Dhe nuk është për t'u çuditur, që Islami e ka bërë leximin e saj obligim të përditshëm, të cilin muslimani e përsërit për çdo ditë jo më pak se shtatëmbëdhjetë herë gjatë pesë namazeve farz të ditës.

CILAT JANË MËSIMET QË PËRCJELLIN BEGATITË?

Mësimet që përcjellin begatitë janë të shumta, por ne do përmendim disa prej tyre:

1. Të jesh i vetëdijshëm se të gjitha begatitë që ti gëzon janë dhuratë prej Allahut të Madhëruar. Njeriu gëzon aq shumë mirësi e begati prej Zotit, saqë po të përpiquej t'i numëronte ato nuk do t'ia dilte asnjë herë, sepse ato janë të pafundme: "Edhe nëse do t'i numëronit

1. Transmetuar nga Muslimi.
2. Kurani, El-Fatiha: 2.

MËSIMET QË MARRIM PREJ BEGATIVE

mirësitë e Allahut, nuk do të mund t'i llogarisnit ato."³

Të gjitha mirësitë, nga më e vogla e deri te më e madhja, janë prej Zotit: Mirësia e shikimit, e dëgjimit, e të folurit, e kujtesës e kështu me radhë. Prandaj njeriu e ka detyrë që ta falënderojë Allahun duke i pranuar, duke i pohuar me gojë dhe duke bërë vepra të mira me gjymtyrë. Allahu i Lartësuar thotë: "Çdo të mirë që zotëroni, e keni prej Allahut".⁴

Një njeri i ka thënë Ebu Hazimit: "Si bëhet falënderimi për sytë o Ebu Hazim?" - Ai u përgjigj: "Kur të shohësh me to ndonjë të mirë, ta përhapësh e kur të shohësh me to ndonjë të keqe, ta mbulosh." – "E si bëhet falënderimi për veshët o Ebu Hazim?" - pyeti përsëri njeriu. Ai u përgjigj: "Kur të dëgjosh me to ndonjë gjë të mirë, t'ia vësh veshin mirë, e kur të dëgjosh me to ndonjë të keqe, t'i pengosh ato nga të dëgjuarit."

"E si bëhet falënderimi për duart o Ebu Hazim?" - pyeti përsëri njeriu. Ai u përgjigj: "Të mos marrësh me to diçka, që nuk është e tyre dhe të mos pengosh me to ndonjë të drejtë ndaj Allahut që bëhet me to." - E si bëhet falënderimi i barkut o Ebu Hazim?" – pyeti përsëri njeriu. Ai u përgjigj: "Që pjesa e poshtme e tij të jetë me ushqim e pjesa mbi të (gjoksi, zemra) të jetë me dituri..."⁵

Transmetohet se Daudi (a.s) i ka thënë Zotit: "O Zoti im, e si të të falënderoj Ty, ndërkohë që vetë falënderimi është mirësi prej Teje?!" – Zoti i Lartësuar i ka thënë: "Pikërisht kështu më ke falënderuar, duke qenë i vetëdijshëm se begatitë që gëzon janë dhuratë prej Meje."⁶

2. Çdo begati që ti e përdor e ka një çmim. Cili është ky çmim që gjithmonë ne duhet të jemi të gatshëm për ta paguar? Ky çmim është llogaridhënia. Allahu i Madhëruar thotë: "Atë ditë, do të pyeteni për mirësitë (e kësaj bote)".⁷ Të gjitha begatitë që ne zotërojmë kanë një faturë të caktuar, që nesër do të japim llogari për to. Kjo nuk duhet që besimtarin ta fusë në panik, por duhet që ta vetdijësojë atë.

Abdurrahman ibn Aufo (r.a) një nga

3. Kurani, En-Nahl: 18.
4. Kurani, En-Nahl: 53.
5. Transmetuar nga Ibn Ebid-Dunja.
6. Kurtubi në tefsirin e tij, te sureja "Sebe", ajeti 13; Medarixhus-Salikine, 2/245.
7. Kurani, Et-Tekathur: 8.

shokët e Pejgamberit (a.s) ishte shumë i pasur dhe sa herë e pinte ujin e ftohtë në vapën e madhe të shkretëtirës i rridhnin lotët nga sytë dhe thoshte: "Për këtë mirësi do të pyetemi, andaj ujin e pimë, por falënderimi ynë ku është?"

3. A mendon se sa njerëz ndoshta nuk e kanë këtë begati që ti e gëzon? Andaj bëhu i kënaqur me atë që të ka caktuar Allahu se do të jesh njeriu më i pasur në botë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Në çdo falënderim ndaj Allahut njeriu merr shpërblimin sikur jep lëmoshë."⁸

Një ditë Aliu (r.a) i ka thënë një njeriut nga fisi Hemedhan: "Begatia vazhdon me falënderim, falënderimi i shton të mirat. Këto dy gjëra shkojnë paralel. Nuk ndërpritet shtimi i begative nga Allahu, deri sa nuk ndërpritet falënderimi nga njeriu."⁹

SI T'I VLERËSOJMË TË MIRAT E ZOTIT?

Për t'i vlerësuar si duhet begatitë e Allahut ndaj nesh dhe për ta falënderuar maksimalisht Atë duhet që të hedhim vështrimin tek të sprovuarit, të varfrit, të sëmurët dhe te njerëzit, që kanë halle e probleme më të mëdha se ne. Për këtë, i Dërguari i Allahut këshillon: "Shihni ata që janë më poshtë se ju (kur bëhet fjalë për çështje të kësaj bote) e jo ata që janë më lart, sepse kjo është më mirë për ju që të mos përçmoni begatitë që ju ka dhuruar Allahu."¹⁰

Një dijetar i ka shkruar letër një vëllait të vet duke i thënë: "Kemi gdhirë me shumë begati nga Allahu, por gjynahet që ne bëjmë nuk arrijmë t'i numërojmë dot. Nuk e di se për çfarë ta falënderoj Allahun më përpara, a për të mirat që na i ka dhënë apo për gjynahet që na i ka mbuluar."

Transmetohet se Muadh ibn Xhebeli (r.a), pas namazit lutej vazhdimisht: "O Zoti im, më ndihmo të të falënderoj dhe të të adhuroj sa më mirë!" Kur e pyetën se pse e bënte këtë lutje kaq shpesh, ai u përgjigj: "Një ditë Pejgamberi (a.s) më tha: - O Muadh, unë të dua për hir të Zotit, kështu që pas namazit asnjëherë mos harro të thuash: "O Zoti im, më ndihmo të të kujtoj, të të falënderoj dhe të të adhuroj sa më mirë."¹¹

8. Transmetuar nga Muslimi.
9. Transmetuar nga Ibn Ebid-Dunja dhe Bejhakui në Shuabul-Iman.
10. Transmetuar nga Buhariu.
11. Transmetuar nga Imam Ahmedi, Ebu Davudi dhe Nesaiu.



“MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI”

Programi veror i aktiviteteve të larmishme me pjesëmarrjen e nxënësve të kurseve fetare/mejtepeve të xhamive të Shkodrës



MALI REPUBLIKA E MALIT

Mali, ose Republika e Malit, është një vend pa dalje në det, dhe ndodhet në Afrikën perëndimore. Ky shtet kufizohet nga Algeria në veri, nga Nigeria dhe Burkina Faso në lindje, nga Bregu i Fildishtë dhe Guinea në jug, dhe nga Senegali dhe Mauritania në perëndim. Vendi ka një sipërfaqe prej 1.241.238 km², dhe një popullsi prej 20.855.999 banorësh (Qershor, 2021).^[1]

Kryeqyteti i vendit është **Bamako**.

RELIEVI

Mali karakterizohet nga një reliev kryesisht i rrafshët dhe monoton, ku mund të dallohen dy tipare themelore: pllajtat dhe fushat, të cilat përshkohen nga dy lumenjtë më të mëdhenj të Afrikës, lumi Niger dhe lumi Senegal. Rajonet malore janë të lokalizuara dhe jo të vazhdueshme.^[2]

Mali ndahet në tre rajone natyrore: Shkretëtirat e thata në veri, fushat gjysmë-shkretëtirë në qendër, dhe tokat e shtrira dhe me gjelbërim në jug. Lartësitë malore janë të pakta në Mali. Maja më e lartë është ajo në malin Hembori Tendo, në jug të vendit, që arrin në rreth 1.155 m mbi nivelin e detit.

Lumi Senegal dhe Lumi Niger, janë dy lumenjtë kryesorë në Mali, ku njerëzit jetojnë në qytete dhe fshatra të vendosura afër luginave të tyre. Lumi Senegal rrjedh në jugperëndim të Malit, ndërsa lumi Niger hyn në territorin e Malit pranë Bamako, pastaj drejtohet në verilindje në një delta të brendshme, e cila është toka më pjellore në Mali. Lumi më pas merr një kthesë të madhe, që njihet si Kthesa e Lumit të Nigerit, dhe më pas drejtohet drejt grykës së tij në jug të Nigerisë, duke lënë nga pas një rrjet kullimesh ujërash dhe liqenesh në territorin e Malit. Mali është një vend në brendësi, i vendosur në perëndimin qendror të Saharasë së Madhe, por lumi i madh Niger rrjedh në jug të vendit, dhe kanalet e tij dhe liqenet me moçal, formojnë një delta të brendshme, të përshtatshme për kultivimin e pambukut dhe orizit. Pa ujitjen nga lumenjtë Niger dhe Senegal, bujqësia në Mali do të ishte e pamundur. Mali Qendror është i thatë, me shkurre të thata dhe ferra.^[3]

KLIMA

Mali shtrihet brenda zonës

intertropikale dhe ka një klimë të nxehtë dhe të thatë, me diellin afër zenitit gjatë gjithë pjesës së vitit. Në përgjithësi vendi ka dy sezone të dallueshme: sezoni i thatë dhe ai i lagësht. Sezoni i thatë, i cili zgjat nga nëntori deri në qershor, karakterizohet nga lagështia e ulët dhe temperaturat e larta, dhe ndikohet nga erërat alize dhe harmatan.

Gjatë sezonit të shirave, nga Qershori deri në Tetor, nga jugperëndimi fryjnë erërat Musone. Të paraprirat nga retë e mëdha dhe të zeza, stuhitë e mëdha të shiut shpesh përfshijnë erëra të stuhishme dhe shumë rrufe dhe bubullima. Temperaturat janë disi më të ulëta në gusht, kur ndodh edhe shumica e reshjeve.

Vendi mund të ndahet në tre zona klimatike: zonat Sudanike, Sahiliane dhe ajo e Shkretëtirës. Klima e zonës Sudanike, në jug, karakterizohet nga temperaturat mesatare prej 24 - 30°C Sahili, ose zona në kufi me Saharanë, ka temperatura mesatare midis 23 dhe 36°C. Në Shkretëtirë (në Sahara), temperaturat gjatë ditës variojnë nga 47 - 60°C, ndërsa natën bien në 4 - 5°C.^[4]

EKONOMIA

Mali është një vend me ekonomi jo të zhvilluar, ku më shumë se tre të katërtat e popullsisë merren me bujqësi dhe blegtori. Nga prodhimet bujqësore kultivohen kryesisht duhani, orizi, misri, etj, kurse prodhimet më të rëndësishme fitimprurëse janë pambuku dhe kallami i sheqerit.

Nomadët endacakë merren më së shumti me ruajtjen e kopeve të mëdha të lopëve, deleve dhe dhive. Peshkimi është gjithashtu një aktivitet i rëndësishëm ekonomik, ku shumicën e prodhimit e përbën krapi, mustaku dhe peshqit e lumenjve. Sektori i shërbimeve në Mali thihet 15% të fuqisë punëtore, shumica e të cilëve punojnë në kryeqytetin Bamako, dhe në qytete të tjera. Industria e tekstilit, ushqimit dhe produkteve të lëkurës, konsiderohen nga aktivitetet më të rëndësishme industriale në vend.

Qeveria zotëron të gjitha fabrikat e mëdha, por gjithashtu e inkurajon edhe rritjen e investimeve individuale.

Mali ka depozita të boksitit, bakrit, arit, hekurit, manganit, fosfatit, kripës dhe të uranumit.^[5]

GJUHA

Frëngjishtja është gjuha zyrtare e Malit, por gjuhët e familjes Niger-Kongo janë ato që dominojnë. Njëra prej tyre, gjuha bambara, përdoret nga rreth katër



të pestat e popullsisë. Gjuhët Mande - përfshirë bambara, malinke, kasonke, vasulunka dhe soninke - kanë numrin më të madh të folësve.

Ndër gjuhët e tjera të Malit janë varietetet e gjuhëve Semite (Afro-Aziatike) dhe Songai (Nilo-Sahariane). Mourët dhe Tuaregët flasin dhe shkruajnë arabisht, megjithëse Tuaregët gjithashtu kanë ruajtur gjuhën e tyre tradicionale Amazige dhe sistemin e tyre të veçantë të shkrimit (tifinag), i cili rrjedh nga gjuha Libiane e lashtë. Gjuha Songai është ajo që përdoret përgjatë lumit Niger.

FEJA

Islami është feja mbizotëruese në vend, që ndiqet nga 90% e popullsisë. Krishterimi zë vendin e dytë pas Islamit (e ndjekur nga 5% e popullsisë), kurse pjesa e mbetur janë ndjekës të feve lokale.

HISTORI


Pikturat dhe gdhendjet në shkëmb

tregojnë se Mali i Veriut ka qenë i banuar që nga kohërat parahistorike, kur Saharaja ishte një tokë pjellore. Bujqësia u zhvillua nga viti 5000 p.e.s, dhe hekuri u përdor atje rreth vitit 500 p.e.s. Vendbanime të mëdha filluan të zhvilloheshin në vitin 300 e.j, përfshirë zonën Dxhenne.

Mali dikur ishte pjesë e tre perandorive të famshme të Afrikës Perëndimore, të cilat kontrollonin tregtinë trans-sahariane të arit, kripës, skllevërve dhe mallrave të tjerë të çmuar, kryesisht gjatë mbretërimit të Mansa Musa (1312 – 1337 e.j). Këto mbretëri Saheliane nuk kishin as kufij të ngurtë gjeopolitikë dhe as identitete të ngurta etnike. Më e hershmja e këtyre perandorive ka qenë Perandoria Gana, e cila mbizotërohej nga Soninkët, një popull që flisnin gjuhën Mande. Perandoria u zgjerua në të gjithë Afrikën Perëndimore nga shekulli i 8-të e deri në vitin 1078, kur u pushtua nga Almoravidët.

Perandoria Mali u formua më vonë në pjesën e sipërme të lumit Niger, dhe arriti kulmin e fuqisë së saj në shekullin e 14-të. Nën Perandorinë Mali, qytetet antike Dxhenne dhe Timbuktu, ishin qendra të shquara të tregtisë dhe të studimeve Islame.

Gjatë fundit të shekullit të 19-të, Mali ra nën kontrollin e Francës. Rreth vitit 1905, pjesa më e madhe e zonës ishte nën kontrollin e Francës, si pjesë e Sudanit Francez (me këtë emër njihet ajo zonë). Më 24 nëntor 1958, Sudani Francez (i cili ndryshoi emrin në Republikën Sudanese) u bë një republikë autonome brenda Komunitetit Francez. Në janar të vitit 1959, Mali dhe Senegali u bashkuan për të formuar Federatën e Malit, e cila e fitoi pavarësinë nga Franca më 20 qershor të vitit 1960. Senegali u tërhoq nga federata në Gusht të vitit 1960, gjë e cila e lejoi Republikën Sudanese të bëhej Republika e pavarur e Malit, me 22 Shtator të vitit 1960. Kjo datë tani është edhe Dita e Pavarësisë së Malit.



Xhamia e madhe
Dxhenne, Mali

ISLAMI NË MALI

Mali në gjuhën Mandi do të thotë: Vendi ku jeton mbreti. Feja zyrtare e këtij shteti të ri ishte Islami.

Kjo mbretëri u themelua nga populli Mandingo, dhe fjala Mali është një ndryshim i fjalës Mandingo, që do të thotë: ata që flasin gjuhën Mandi. Ky popull u konvertua në Islam në fund të shekullit të njëmbëdhjetë të erës sonë, gjatë lëvizjes së Murabitinëve (Almoravide).

Ky shtet i vogël që filloi me Mbretërinë Kanxhaja, arriti të zotëronte fuqi ushtarake në rajonin Niaini, një qytet i vendosur në perëndim të lumit Niger, jo shumë larg kufijve të Guinesë së sotme.

Shteti i Malit u krijua nën udhëheqjen e Sindiata-s, themeluesit të kësaj mbretërie. Ai arriti në fronin e Malit rreth vitit 1245 e.j, dhe e drejtoi atë vend për njëzet e pesë vite. Sindiata arriti që mbretërinë e tij të vogël ta bënte një perandori e madhe, pasi që mori nën zotërim pjesët e mbetura nga Perandoria e Ganës, dhe pasi mposhti Mbretin e Perandorisë Soso dhe aneksoi tokat e tij. Më pas, ai themeloi një kryeqytet të ri në Niaini (që nganjëherë quhet Mali).

Mali zuri një pozicion të rëndësishëm tregtar në Sudanin Perëndimor, dhe vazhdoi ta mbante këtë pozicion derisa

erdhi djali i tij Aliu, i cili mbajti titullin Mansa, që në gjuhën Mandi do të thotë Sulltan ose Zotëri. Edhe ky ndoqi të njëjtën qasje si të babait të tij, dhe qëndroi në pushtet nga viti 1260 e deri në vitin 1277 të erës sonë. Edhe ky, si mbretërit e tjerë, bëri një udhëtim Haxhi në Vendet e Shenjta.

Kështu ishte dalja e shtetit të Malit në skenën e ngjarjeve politike në Afrikën Perëndimore.

Zgjerimet e këtij shteti në lindje dhe në perëndim, ndihmuan në përhapjen e Islamit dhe të civilizimit të tij, veçanërisht pasi ky shtet mori kontrollin e rrugëve tregtare, të minierave të arit dhe të kripës. Përveç prosperitetit tregtar që mbizotëroi në këtë perandori, në të u shfaqën edhe manifestime të prosperitetit kulturor si edhe konsolidimi i marrëdhënieve me fuqitë fqinje. Udhëtimi i famshëm i Haxhit, gjë e cila u bë e njohur në atë rajon, pati ndikim të madh për zhvillimin e diturisë dhe të kulturës në vend, dhe solli shumë ndryshime në sistemin e ndërtimit, të rrugëve tregtare, në ndërtimin e xhamive dhe të minareve. Kjo bëri që atje të vinin juristë dhe të dijetarë muslimanë, të cilët ndihmuan në përhapjen e mësimave Islame në atë zonë, kryesisht të shkollës së Imam Malikut. Falë përpjekjeve të studiuesve nga Egjipti dhe Marakish, në Mali filloi të shfaqej një jetë autentike islame.^[6]

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, teologe


1. <https://www.worldometers.info>
2. <https://www.britannica.com>
3. <https://ar.wikipedia.org>
4. <https://www.britannica.com>
5. <https://ar.wikipedia.org>
6. <https://islamstory.com/ar>

TETOVË, PËRCILLET PËR NË AMSHIM “MUALIMI MË I MIRË NË BOTË”, MULLA MAHMUD EF. ASLLANI

Mijëra besimtarë morën pjesë në faljen e namazit të xhenazës dhe varrimin e mualimit të mirënjohur nga Tetova, mulla Mahmud ef. Asllani, i cili ndërroi jetë mbrëmë, raporton Anadolu Agency (AA).

Në përcjelljen në amshim të të ndjerit, i pranishëm ishte kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut (BFI), Shaqir Fetahu, si dhe mufti dhe përfaqësues të tjerë të BFI-së, përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), atasheu për çështje fetare në Ambasadën e Turqisë në Shkup, Mustafa Mesten, krerë të institucioneve kulturore dhe besimtarë të shumtë.

Namazi i xhenazës u fal nga djali i tij, hafëz Zulfuqfi ef. Asllani, pas namazit të iqindisë në Xhaminë e Larmë në Tetovë, ndërsa varrimi u bë në varrezat e qytetit.



marrë asnjë ditë pushim, përveç nga dy ditë gjatë festave të Bajramit. Thuhet se këtë e ka bërë gati për gjysmë shekulli, respektivisht që nga viti 1967.

Në vitin 2012, Organizata botërore për mësimin e Kur'anit përmendësh, me seli në Xhidde të Arabisë Saudite, e shpalli hoxhën nga Tetova si “mualim më të mirë në botë”.



Mulla Mahmud ef. Asllani, i cili lindi më 15 mars të vitit 1932 në fshatin Çiflik të Tetovës, njihet si një person i cili për çdo ditë që para namazit të sabahut deri pas akshamit ka qëndruar dhe ka mësuar nxënësit në xhami dhe nuk ka

Pas kthimit nga Arabia Saudite me çmimin e fituar, mulla Mahmud ef. Asllani konsiderohej si simbol i suksesit të Xhamisë së Larmë në Tetovë, pasi thuhet se në duart e tij hifzin e kanë kryer afër 200 hafizë, ndërsa leximin e Kur'anit e kanë mësuar me mijëra nxënës.

Disa funksionarë turq, duke parë kushtet e hoxhës, morën iniciativë për ndërtimin e një godine afër xhamisë ku hoxha të ketë kushte më të mira për punë dhe për jetesë. Kjo gjë ndodhi në vitin 2011, ku në hapjen solemne të objektit ishte i pranishëm edhe vetë kryeministri i atëhershëm dhe presidenti aktual i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan.

(www.aa.com.tr/sq)



I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

“*Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson atë të tjerëve!*”

(Transmetuar nga Buhariu)



A E DINI SE?

Në Andaluzi ndodhet një qytet me emrin Mursia. Ky qytet u themelua në vitin 209 hixhri (825 gregorian) nga ana e Abdurrahmanit II, emirit të Kordobës. Pas afro dy shekujsh nga themelimi i tij, konkretisht në vitin 398 hixhri (1008 gregorian) në këtë qytet lindi dijetari i madh Ibën Siideh.

eadham” i botuar në 11 vëllime.

2. Enciklopedia gjuhësore “el-Muhassas”, që është vepra e tij më e njohur dhe e botuar në 8 vëllime të mëdha. Kjo vepër llogaritet si “kible” e gjuhëtarëve, ngase në vete ngërthen principet e gjuhës arabe, veçoritë e saja si dhe lidhjen e saj me aspektet jetësore.



Ibën Siideh el-Mursi el-Endelusi el-Darir ishte njëri ndër gjuhëtarët, filologët dhe leksikografët më të mëdhenj që ka pasur bota islame. Hafiz Dhehebiu e cilëson si “imami i gjuhës arabe”. Ndërsa, Hafiz Ibën Haxheri deklaroi se: ai ishte njeriu më i ditur i kohës së tij në shkencat gjuhësore.

Imam Ibën Siideh në vitin 458 hixhri (1066 gregorian) duke marrë abdesin e akshamit sëmuret dhe pas dy ditësh ndërroi jetë.

Ai është autor i disa veprave shumëvëllimshe, shumica e të cilave gjatë shkatërrimit të Andaluzisë nuk i shpëtuan humbjes. Fatmirësisht 3 prej veprave të Ibën Siides kapërcyen rrezikun e zhdukjes dhe sot janë të botuara si dhe gjenden me lehtësi, prej tyre theksojmë:

1. Fjalori “el-Muhkem ve'l-muhit el-

E gjithë kjo që u tha bëhet edhe më e habitshme kur mësojmë se imam Ibën Siideh lindi dhe jetoi i verbër, për atë njihet edhe si “el-Darir”. Madje edhe babai i tij ishte i këllillë.

P.s. për skeptikët: Imam Ibën Siideh për shkak të verbërisë së syve mësimet i ka memorizuar vetëm me dëgjim, ngase ka pasur një kujtesë dhe memorie të jashtëzakonshme. E më vonë kur ka filluar shkrimin e librave të veta si autor, atë e ka bërë me metodën e diktimit, d.m.th. ai ka folur dhe nxënësit e tij përnjëherë e kanë bërë regjistrimin e fjalisë në vendin ku ai i ka urdhëruar.

(Në fotografi duken 2 librat e përmendur)


Ambicie të mahnitshme, Allahu e mëshiroftë!

Hazir D. Selmani



ARABIA SAUDITE AUTORIZON HAXHIN NË MEKË PËR 60.000 REZIDENTË TË VAKSINUAR

Arabia Saudite do të autorizojë 60.000 rezidentët e saj të vaksinuar kundër koronavirusit të kryejnë Haxhin, një pelegrinazh i madh mysliman në Mekë që do të zhvillohet muajin e ardhshëm, njoftoi sot Ministria e Haxhit, sipas agjencisë zyrtare SPA.



Gjatë haxhit të fundit, një nga pesë shtyllat e Islamit, vetëm dhjetëra mijëra besimtarë që banonin në Arabinë Saudite ishin në gjendje të kryenin këtë rit, nga 2.5 milionë e pjesëmarrësve nga e gjithë bota në 2019, për shkak të pandemisë së Covid-19.

“Ata që duan të kryejnë Haxhin duhet të jenë midis 18 dhe 65 vjeç, të mos vuajnë nga një sëmundje kronike dhe të jenë vaksinuar”, theksoi ministria në një deklaratë të transmetuar nga SPA.

Në prill, mbretëria kishte njoftuar tashmë se vetëm njerëzit e vaksinuar do të lejoheshin të kryenin Umrah, pelegrinazhi i vogël mysliman që mund të kryhet gjatë gjithë vitit, nga fillimi i muajit të agjërimit mysliman të Ramazanit, duke shkaktuar pakënaqësi.

Pelegrinazhi i vogël, i pezulluar në mars 2020 për shkak të pandemisë, rifilloi me rezerva në fillim të tetorit me masa drastike parandaluese në këtë vend të Gjirit më të prekur nga epidemia.

Në fillim, vetëm 6.000 sauditë dhe banorë të huaj në Arabinë Saudite u lejuan të kryenin Umrah çdo ditë, para se ky numër të arrinte në 20.000.

Rreth 60.000 persona janë autorizuar për të kryer lutjet e para ditore në Xhaminë e Madhe të Mekës, qyteti i parë i shenjtë i islamit.

(www.radiojehona.al)

MYFTIU PRITI AMBASADOREN E PALESTINËS NË TIRANË, ZNJ. HENA ESH-SHEVA

Paraditën e mërkurë, më 2 qershor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari priti priti në një takim të ngrohtë dhe të përzemërt ambasadore e Shtetit të Palestinës, Znj. Hena Esh-Sheva.

Në postimin e tij në facebook, Myftiu i Shkodrës u shpreh:

“Pata kënaqësinë e madhe të pres sot, në një takim kortezie, Shkëlqesinë e Saj, Znj. Hena Esh-Sheva, Ambasadore e Shtetit të Palestinës në vendin tonë.

Palestina martire dhe Kudsi Sherifi, kanë një vend të shtrenjtë e të shenjtë në zemrën dhe vetëdijen e çdo muslimani, sikurse mbeten njësi matëse e humanizmit dhe ndershmërisë së njeriut me vetveten dhe vlerat universale.

I shpreha zonjës ambasadore faktin e patjetërsueshëm të lutjeve të muslimanëve shkodranë dhe qytetarëve të këtij vendi për vëllezërit tanë në



tokën e shenjtë, për paqen dhe sigurinë, sikurse i shpreha se kemi dënuar dhe dënojmë dhunën, terrorin, shkatërrimin dhe barbarinë, me të cilat përballën palestinezët prej dekadash.

Ishim të një mendimi dhe besimi se premtimet kuranore janë shpresa më e madhe, për të sotmen dhe të ardhmen e asaj toke, njeriut dhe njerëzimit mbarë!

Dëgjova me kënaqësi shpjegimet interesante të Shkëlqesisë së Saj rreth Xhamisë së Kudsit, historisë dhe detajeve të mrekullueshme të trashëgimisë shpirtërore, historike dhe kulturore të asaj toke të shenjtë, ku prej shekujsh, muslimanë, hebrenjë e të krishterë jetojnë në paqe e harmoni të admirueshme.”

MYFTIU PRITI DREJTORIN E RI TË KADASTRËS SHKODËR



Ditën e mërkurë, më 9 qershor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim pune drejtorin e ri të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër, z. Flladi Dano.

Gjatë takimit, u diskutua edhe për gjendjen e shumë dosjeve dhe aplikimeve të pronave vakëf, për të cilat Myftinia Shkodër interesohet dhe punon prej shumë vitesh.

Disa prej tyre janë certifikuar dhe vënë në shërbim, por akoma sot, shumë prej tyre presin të kalojnë kufirin e certifikimit përfundimtar, për t'i hapur rrugë projekteve të ndryshme, që i shërbejnë vetë vakëfit, aktivitetit fetar dhe komunitetit.

U ra dakord që të vazhdohet bashkëpunimi për ndjekjen me përparësi të një grupi prej dosjeve më të ndjeshme.

U PROMOVUA LIBRI: “HYRJE NË SISTEMIN FINANCIAR ISLAM”



Ditën e enjte, më 10 qershor 2021, në ambientet e mrekullueshme të lulishtes së xhamisë “Ebu Bekër” në Fushë-Çelë, u zhvillua promovimi i librit “Hyrje në sistemin financiar islam”, një publikim i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam, me mbështetjen e



Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

Të pranishëm në këtë promovim ishin drejtues të Bankës UBA, drejtori i AIITC, Dr. Ardian Muhaj, dhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari.

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës dhe nga drejtori i Bankës UBA, z. Amel Kovaçević.

Fjalën e rastit e mori edhe drejtori i AIITC, Dr. Ardian Muhaj, i cili hodhi dritë mbi rëndësinë e këtij libri, të shkruar nga dijetari i shquar islam bashkëkohor, Myftiu Muhammed Takijudin El-Usmani.

Kjo vepër ka si qëllim sigurimin e informacionit themelor mbi rregullat dhe parimet e financave islame, me theks të veçantë në mënyrat e financimit të përdorura nga bankat dhe institucionet financiare jobankare islame.

FILLOI PROGRAMI VEROR “MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI” ME NXËNËSIT E XHAMIVË TË SHKODRËS

Ditën e enjte, më 17 qershor 2021, në ambientet e Kompleksit “Zmijani” u hap programi veror i aktiviteteve të larmishme “Mësojmë dhe argëtohem”, me pjesëmarrjen e nxënësve të kurseve fetare/mejtepeve të xhamive të Shkodrës.

Në ditën e parë të këtij programi arsimor, kulturor dhe argëtues morën pjesë rreth 120 fëmijë të xhamive: Barbullush, Bardhaj, Zues, Gur i Zi dhe Rragam.

Drejtesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni në fjalën hapëse të këtij programi i uroi fillimisht mirëseardhjen nxënësve të kurseve fetare si dhe prezantoi programin e këtyre aktiviteteve që tashmë janë bërë traditë e përvitshme, duke thënë se përmbajtja e tyre do të përfshijë: konkurse, biseda, lojëra argëtuese e sportive, shëtitje, ekskursione si dhe vizita historike në



objekte të trashëgimisë sonë islame dhe kombëtare.

Këto aktivitete kanë për qëllim që fëmijët dhe të rinjtë tanë, përmes këtyre veprimtarive të gjalla të stimulohen, të afrohen më shumë nga e mira dhe larg të keqes, si dhe të argëtohen, përveç arsimit dhe edukimit, me mësimet



fetare që marrin herë pas here në xhamitë tona.

Më pas programi vijoi me zhvillimin e një konkursi, bisedave, lojëra të ndryshme sportive etj.

Programi i aktiviteteve “Mësojmë dhe argëtohem”, do të vijoi me të tjera xhami gjatë periudhës së verës.



MYFTIU VIZITOI KËSHILLTARIN PËR ÇËSHTJET FETARE TË TURQISË

Paraditën e së martës, më 22 qershor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vizitoi në Tiranë Këshilltarin për Çështjet Fetare në Ambasadën e Republikës së Turqisë në vendin tonë, z. Bekir Yanılmaz.

Gjatë këtij takimi të përzemërt, Myftiu falënderoi kontributin e Këshilltarit Bekir Yanılmaz për ruajtjen e frymës së bashkëpunimit dhe vëllazërisë, për të cilën, Myftiu theksoi se është e një rëndësie të veçantë për vendin tonë dhe marrëdhëniet shekullore, historike dhe strategjike që ne kemi me Republikën e Turqisë.

Myftiu shprehu mirënjohjen e tij, të besimtarëve dhe të Myftinisë Shkodër për shërbimin plot përkushtim të dy hafizëve të nderuar nga Turqia, që falë bashkëpunimit me zyrën e Këshilltarit



Yanılmaz, ishin pjesë e aktiviteteve të Ramazanit të sivjetshëm në Shkodër, duke shërbyer në xhami të ndryshme pranë besimtarëve të qytetit të Shkodrës.

Nga ana e tij, z. Bekir Yanılmaz falënderoi Myftiun Sytari për vizitën dhe frymën e bashkëpunimit, sikurse shprehu gatishmërinë e tij dhe të

institucionit që përfaqëson për të vijuar në bashkëpunime të mëtejshme në shërbim të besimtarëve.

Gjatë këtij takimi u diskutua për rritjen e frymës së bashkëpunimit, sidomos në fushën e botimeve dhe aktiviteteve me vlerë të përbashkët.

MYFTIU NGUSHËLLOI FAMILJARËT E MULLA MAHMUD EF. ASLLANIT NË TETOVË

Të mërkurën, më 23 qershor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari me bashkëpunëtorë, ishte për vizitë në familjen Asllani në Tetovë, ku shprehu ngushëllimet e tij për humbjen e Hoxhës dhe Muhafizit të shquar të trojeve shqiptare, Mulla Mahmud ef. Asllani.

Myftiu theksoi se largimi nga kjo jetë e dijetarëve dhe eulijave, prej atyre që i shërbyen tërë jetën çështjeve madhore të fesë dhe edukimit të brezit të ri, shkakton dhimbje dhe na ngarkon me përgjegjësi të mëdha, që pasojnë boshllëkun që ata lënë.

Myftiu Sytari tha se Mulla Mahmud



ef. Asllani ishte dhe mbeti një yll ndriçues, që na bën të ndjehemi krenarë për veprën dhe përkushtimin e tij, sikurse dëshmoi me përkushtimin e tij ndaj Kuranit Famëllartë shkrijen në shërbimet e singerta për mësimin dhe transmetimin e Fjalës së Allahut tek brezat që vijnë.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu u takua edhe me Myftiun e Tetovës, të nderuarin prof. Qani ef. Nesimi, me të cilin zhvilloi një bashkëbisedim të ngrohtë e vëllazëror.

IMAMËT E SHKODRËS, LIGJËRIME KUNDËR DEGRADIMIT MORAL E SHOQËROR

Në takimin e zhvilluar ditën e enjte, më 24 qershor 2021, me imamë të Myftinisë Shkodër, Myftiu Imam Muhamed B. Sytari, tërhoqi vëmendjen drejt domosdoshmërisë së shfrytëzimit të hytbes së xhumasë për të ngritur alarmin rreth fenomeneve degraduese të tabanit tonë kombëtar, përhapjes së dhunshme të injorancës, idhujtarisë moderne, imoralitetit e korrupsionit, mungesës së sigurisë dhe shturrjes, tentakulat e së cilës po përhapen frikshëm ditë pas dite dhe pa asnjë lloj filtri a konsiderate!



Myftiu tha se duke nisur nga dita e xhuma, më 25 qershor 2021, në të gjitha minberet e Shkodrës të flitet rreth tematikave të kthimit nga Zoti dhe feja e Tij, drejt pendimit dhe moralit, distancimit nga e keqja dhe ndërtimi i jetës mbi bazat e besimit, ndershmërisë, pastërtisë e moralit.

Në këtë takim Myftiu ngriti edhe disa tematika që lidhen me aktivitetin e xhamive, afrimin e rinisë dhe brezit të ri, si dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së ekuilibrave në bashkësinë tonë islame.

Në takim ishte i pranishëm edhe Imam Didmar Faja, Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Arizona, i cili iu drejtua imamëve me një këshillë të urtë e plot dobi.



VIJON PROGRAMI I AKTIVITETEVE “MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI”

Ditën e enjte, më 24 qershor 2021, programi i aktiviteteve “Mësojmë dhe argëtohemi” vijoi me pjesëmarrjen e rreth 70 nxënësve të kurseve fetare/mejtepeve të xhamive të Shkodrës, Dragoç dhe Kullaj, nën kujdestarinë e mësuesve të përkushtuar, Shkëlqin Sykaj dhe Ardin Selhani.

Aktiviteti filloi me zhvillimin e një takimi dhe bisedë me nxënësit tek Qendra Kulturore Postrribë, pranë xhamisë Dragoç, ku drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni u foli mbi rëndësinë që ka mësim-besimi, roli i mejtepeve/kurseve fetare në edukimin e brezave me mësimet islame si dhe u prezantoi edhe programin e aktivitetit të sotëm.

Më pas, nxënësit vizuan me një vizitë kulturore në xhaminë historike dhe shekullore të Plumbit, ku përmes teologut Halluni dhe një prej nismëtarëve të



rihapjes së xhamisë, z. Abdullah Myftia u njohën me historikun dhe vlerën e madhe që ka ky objekt kulti islam, si pionierja e parë për rilejimin më pas të besimit në vendin tonë.

Nxënësit, vizituan po ashtu edhe një vakëf të lashtë dhe gjurmët shekullore të xhamisë së Tabakëve, prej të cilave nxënësit mësuan historikun, kulturën

dhe lashtësinë e kësaj zone dhe lagje të vjetër shkodrane, e mbushur plot dëshmi besimi, harmonie dhe dije.

Aktiviteti përfundoi me një shëtitje dhe piknik argëtues në zonën turistike të Shirokës.

Kujtojmë se, programi i aktiviteteve “Mësojmë dhe argëtohemi”, do të vijojë me të tjera xhami gjatë periudhës verore.



MYFTIU: “JETËN JEMI URDHËRUAR TA ZHVILLOJMË, JO TA VRASIM E TA SHKATËRROJMË!”

Paraditën e së hënës, më 28 qershor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në xhenazen e të riut jetim Musaen Zeneli, 20 vjeçarit, që humbi jetën në mënyrë tragjike një ditë më parë në tragjedinë e dhimbshme të Velipojës, ku katër persona mbetën të vrarë dhe dy të tjerë të plagosur.

Myftiu iu drejtua të pjesëmarrësve që kishin ardhur për të shprehur ngushëllimet e tyre, duke theksuar se njeriu ka ardhur në këtë botë për ta jetuar jetën e tij të përkohshme me besim e dinjitet, për të ndërtuar e zhvilluar të mirën, jo për ta konsideruar atë si mallin më të lirë e të pavlerë!

“Allahu të mëshiroftë, djali ynë, që po largohesh nga kjo botë, duke shpëtuar nga propaganda e mjerimi, nga statutet në fb të atyre që po e shkatërrojnë këtë



vend e që sot “qajnë” për ty; nga statutet populiste e të pavlera, që vlerësohen më shumë se zemra e djegur e nënës tënde, që nuk do të gjejë më rehati, sa të ketë jetë!

Allahu të mëshiroftë e të pranoftë me

butësinë e faljen e Tij, e ne na udhëzoftë se shumë larg kemi devijuar rrugën!”, – tha ndër të tjera në fjalën e tij para faljes së namazit të xhenazes, që u dëshmuar nga besimtarë të shumtë, imamë e drejtues të shoqatave bamirëse.

SHFRYTËZO PESË GJËRA PARA PESË TË TJERAVE

Ibn Abasi (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s)
i tha një njeriu duke e porositur:

“Shfrytëzo pesë gjëra para pesë të tjerave:

- 1- Rininë tënde para pleqërisë,
- 2- Shëndetin tënd para sëmundjes,
- 3- Pasurinë tënde para varfërisë,
- 4- Kohën tënde të lirë
para se të jesh i zënë me punë,
- 5- Jetën tënde para vdekjes”.

(Transmetuar nga Hakimi dhe Bejhakiu)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org